



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PESHKOPI

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Albania, nr. tel 0218.221.66

KONTRATE

PER OBJEKTIN :

*" Hartim projekti teknik per objektin Rinovim i infrastruktures se bulevardit  
Elez Isufi, rruges Safet Zhulali dhe rruges se Muzeut "*

Kjo kontrate lidhet sot me daten 08/07/2014 ne Bashkine Peshkopi midis paleve si vijon:  
Bashkia Peshkopi, te perfaqesuar nga kryetari z. Ilir KROSI me cilesine e perfaqesuesit te  
institucionit dhe subjektit " Roalb Studio" perfaqesuar nga drejtuesi ligjor Z.Hamza Kazia  
me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Permbajtja e kontrates eshte si me poshte vijon :

OBJEKTI I KONTRATES:

Neni 1

*" Hartim projekti teknik per objektin Rinovim i infrastruktures se bulevardit  
Elez Isufi, rruges Safet Zhulali dhe rruges se Muzeut "*

VLERA E KONTRATES

Neni 2

Eshte vlefte e kontrates e pranuar nga ofertuesi "Roalb Studio " ne tenderin e dates  
23/06/2014 dhe e cilesuar si oferte fituese mbeshtetur ne vendimin e Komisionit te Vleresimit  
te Ofertave dhe te miratuar nga Titullari i AK Z. ILIR KROSI per vleren te shprehur ne  
shifra 594.000 leke me TVSH

AFATI I KONTRATES



Neni 3

Kontrata duhet te realizohet brenda nje afati prej 30 ditesh kalendarike nga data e lidhjes se kontrates .

**DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

**TE DREJTA DHE DETYRIME**

Neni 4

Materialet e nevojshme per kryerjen e sherbimit si ne objektin e kontrates sigurohen nga sipermarresi .

Neni 5

Sipermarresi duhet te paralajmeroje ne kohen e duhur bashkine Peshkopi :

- a.kur dokumentacioni per kryerjen e sherbimeve ka te meta ose nuk eshte i plote .
- b.kur udhezimet e porositesit nuk mund te zbatohen
- c.kur ka rrethana qe nuk varen nga sipermarresi te cilat ndikojne qe vepra te mos jete e qendrueshme .

Neni 6

Sipermarresi ka te drejte te kerkoje ti paguhet sherbimi i kryer kur vepra para se ti dorezohet porositesit (autoritetit kontraktor humbet ose demtohet per shkak te zbatimit te udhezimeve te porositesit per kryerjen e vepres )mgjths per kete sipermarresi kishte lajmeruar ne kohe porositesin .

Neni 7

Sipermarresi eshte i detyruar te rregulloje maredheniet me punonjesit e tij sipas ligjit Nr.7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise "

Neni 8

Sipermarresi do te mbuloje ne emer te tij te punesuarit nga dita e fillimit e deri ne Fund te periudhes se pergjegjesise per difekte t e te gjitha detyrimet per sigurimet qe lidhen me rreziqet qe sipermarresi duhet te perballoje .

Neni 9

Sipermarresi do te kryeje dhe realizoje punimet ne perputhje me specifikimet dhe skicat .

Neni 10



Sipermarresi nuk mund te ndryshoje menytrat e caktuara ne kontrate per kryerjen e sherbimeve ,pa pelqimin me shkrim te autoritetit kontraktor .

Edhe kur eshte dhene pelqimi ,sipermarresi ,po qe se cmimi i plote i vepres eshte caktuar ,nuk ka te drejte te kompensohet per ndryshimet ose per shtesat ,pervесе kur ka mareveshje te kundert .

#### Neni 11

Kur sherbimi i kryer me material te sipermarresit humbet ose demtohet si dhe kur perfundimi i saj behet i pamundur para se te kete mbaruar afati per dorezimin e vepres ,por ne cdo rast pa fajin e asnjërit prej tyre ,sipermarresi nuk ka te drejte ti kerkoje porositesit qe ti paguhet vlefta e materialit dhe puna e kryer .

#### Neni 12

Sipermarresi nuk mund te jape me nensipermarrje kryerjen e vepres ose te sherbimeve pa u marre pelqimi nga porositesi .

#### Neni 13

Sipermarresi detyrohet te jape garanci per deformimet dhe veset e vepres .Garancia nuk kerkohet kur posrositesi e ka pranuar vepren dhe deformimet ose veset njiheshin prej tij ose ishin te dallueshme ,pervec kur ato jane fshehur me keqbesim nga sipermarresi .  
Punedhenesi duhet te njoftoje ndaj sipermarresit deformimet ose veset brenda 60 diteve nga zbulimi i tyre me kusht dekadence qe sjell humbjen e kesaj te drejte .Njoftimi nuk eshte i domosdoshem kur sipermarresi i ka njohur dhe pranuar ose i ka fshehur ato .  
Padia kunder sipermarresit parashkruhet brenda dy vjeteve nga data e dorezimit te vepres .

#### Neni 14

Drejtori punimeve do te kontrolloje punen e kryer nga sipermarresi dhe do te vertetoje shumen qe duhet ti paguhet sipermarresit brenda 20 diteve nga paraqitja e situacionit .Vlera e punimeve te kryera do te percaktohet nga drejtori i punimeve dhe do te perfshije vleren e volumeve te zerave te punimeve te perfunduara dhe te shprehura ne preventiv .

#### Neni 15

Pagesa e punes se kryer do te perfshije vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara .

#### Neni 16

Pagesa per cdo situacion punimesh do te kryhet nga autoriteti kontraktor ,brenda 15 diteve nga dita e firmosjes se situacionit te punimeve .



### Neni 17

Zerat punimeve per te cilat nuk eshte vene emimi per njesi ne oferten e paraqitur ,nuk do te paguhen nga autoriteti kontraktor ,dhe do te konsiderohen si te mbuluara nga vlera dhe emimet e tjera te perfshira ne kontrate .

### KORIGJIMI I DEFEKTEVE

### Neni 18

Drejtori i punimeve do te njoftoje sipermarresin,lidhur me cdo defekt ,para mbarimit te periudhes se garancise per defektet .

- 1) Cdo here qe njoftohet nje difekt ,sipermarresi do te korigjije difektin brenda afatit te parashikuar nga njoftimi i drejtorit te punimeve .
- 2)Nqs sipermarresi nuk e korigjon difektin brenda afatit te percaktuar me njoftimin e drejtorit te punimeve ,ky i fundit do vleresoje koston e korigjimit te difektit dhe sipermarresi do e paguaje keke shume ,ose autoriteti kontraktor do ti mbaje keto shuma duke i zbritur nga pagesat pasardhese .

### Neni 19

Sipermarresi do ti paguaje demshperblim vonese porositesit me vlere ditore te percaktuar ne te dhenat e kontrates per cdo dite qe dote vonohet perfundimi pas periudhes se kerkuar te perfundimit .Sasia e pergjithshme e demeve te likujduara ,nuk do te tejkaloje sasine e percaktuar ne te dhenat e kontrates .Autoriteti kontraktor do te zbrese demshperblimin per vonesat nga pagesa e fundit ,per sipermarresin .

### Neni 20

Riparimet qe dalin te nevojshme gjate kolaudimit te vepres ,nese jane per shkak te mosplotesimit te kontrates ose punes jo cilesore te sipermarresit ,do te mbulohen nga ky i fundit .

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTOR

### Neni 21

Te vendos ne dispozicion te sipermarresit ,Projekte dhe territorin i cili eshte miratuar nga autoriteti kontraktor .

### Neni 22

Te nderhyje si organ vendim marres per te krijuar kushtet per zbatimin e kontrates .

### Neni 23



Te kryeje pagesat ne menyre te rregullt sipas situacioneve te praqitura nga drejtori i punimeve dhe sesioni i sherbimeve .

#### Neni 24

Titullari ose zevendesi tij eshte i deturuar te prese sipermarresin sa here qe ai te hase pengesa subjektive ose ndryshime per efekt te faktoreve qe ai nuk mund ti komandoje .

#### Neni 25

Nqs si rrjedhim i rrethanave te paparashikuara ,kane ndodhur rritje ose ulje te kostos se materialeve ,sipermarresi ose porositesi nuk mund te kerkojne rishikimin e cmimit

#### Neni 26

Porositesi para se te marre ne dorezim punen e mbaruar ,ka te drejte ta kontrolloje ate .Kontrolli duhet te kryhet nga porositesi sapo sipermarresi te krijojte kushtet e duhura per kontrollin .

#### Neni 27

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kontrolloje npm Drejtorit te punimeve ,kryerjen e punimeve .Kur zbulohet se kryerja e tyre nuk vazhdon sipas kushteve te caktuara ne kontrate ,porositesi mund te caktojte nje aft te arsyeshem brenda te cilit sipermarresi duhet te pajtohet me ato kushte ,kur afati i caktuar ka kaluar pa sjelle ndonje dobi .Kontrat a zgjidhet pa cenuar te drejten e porositesit per te drejten e demeve .

#### Neni 28

Porositesi mund ti paguaje nje paradhenie sipermarresit ne shumen e percaktuar ne te dhenat e kontrates ,pasi sipermarresi te siguroje kushtet dhe pajisjet e nevojshme per fillimin e punimeve .

#### Neni 29

Sipermarresi para perfundimit te periudhes se garancise per difektet do ti paraqese drejtorit te punimeve nje llogari te detajuar te shumes totale qe punedhenesi do ta konsideroje te pagueshme sipas kontrates .Drejtori i punimeve do te leshoje kontraten per garancine e difekteve ,brenda 30 diteve nga marrja e llogarise se sipermarresit nese ajo eshte korrekte dhe e perfunduar .

### ZGJIDHJA E KONTRATES

#### Neni 30



Ne kontrata me detyrime te ndersjella kur njera nga palet kontraktuese nuk permbush detyrimet e veta ,pala tjeter kontraktuese ,sipas rastit ,mund te kerkoje permbushjen e detyrimit ose zgjidhjen e kontrates ,pervec shperblimit te demit .

#### Neni 31

Kontrata nuk mund te zgjidhet nqs mospermbushja e detyrimit prej njeres nga palet ka rendesi te pakt per interesat e pales tjeter .

#### Neni 32

Pala kontraktuese mund te njoftoje me shkrim palen tjeter qe nuk ka permbushur detyrimin ,qe ta permbushete ate ne nje afat te pershtatshem ,duke deklaruar se po qe se pas ketij afati kontrata nuk permbushet ,ajo do te quhet e zgjidhur.

#### Neni 33

Nqs afati i caktuar per kryerjen e detyrimit te njeres nga palet duhet quajtur thelbesor per interesat e pales tjeter ,kjo e fundit kur deshiron te kerkoje zbatimin pmvrs nga mbarimi i afatit ,duhet ti beje njoftim pales tjeter ,brenda tre diteve ,pervec mareveshjes se kundert .

#### Neni 34

Palet mund te parashikojne ne kontrate qe ajo te zgjidhet kur nje detyrimi caktuar nuk permbushet sipas kushteve te parashikuara .Ne kete rast kontrata zgjidhet ,kur pala e interesuar i deklaron pales tjeter se do te perdore kushtin e zgjidhjes se kontrates .

#### Neni 35

- a)Shuma prej 10% e sigurimit te kontrates do te clirohet me mbarimin e kontrates ,kur nuk ka verejtje per vepren
- b)Ne te kundert ,shuma prej 10% do ti kaloje porositesit nese kontrata nuk eshte realizuar ose prishet per faj te sipermarresit .

#### Neni 36

##### **Kushti penal**

Per ekzekutimin ose mosekzekutimin e jo ne menyren e duhur te detyrimeve palet mund te parashikojne ne kontrate pagimin e nje shume te hollash ose kryerjen e nje detyrimi tjeter ,per riparimin e demit ose per te nxitur ekzekutimin e detyrimit .

#### Neni 37

Kur kushti penal eshte caktuar per rastin e mosekzekutimit te detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij ,kreditori ka te drejte te kerkoje pagimin e kushtit penal si dhe shperblimin e pjeses se demit qe kalon kushtin penal .Kur kushti penal eshte caktuar per rastin e ekzekutimit te detyrimit jo ne menyren e duhur ,kreditori ka te drejte te kerkoje



ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal si dhe shperblimin e pjese se demit qe kalon kushtin penal .

Kushti penal per mosrespektimin e detyrimeve ne kohe eshte 0.01% ne dite per cdo dite vonese ,por jo me shume se 25% e vleres se kontrates .

### Neni 38

#### Forcat madhore

- a)Forca madhore i cliron palet nga pergjegjesia per mospermbushjen pjesore ose teresore te detyrimeve sipas kushteve te kesaj kontrate .
  - b)Force madhore konsiderohet cdo rrethane e paparashikuar qe nuk varet nga vullneti i paleve dhe pengon plotesisht ose teresisht qe palet te permbushin detyrimet e veta .
  - c)Fillimi dhe perfundimi forces madhore do te njoftohet nga pala brenda 5 diteve .Ne rast te kundert pala pergjegjese nuk do perfitoje nga efektet e forces madhore .
- Ne rast se forca madhore con drejt nje shtyerje prej 6 muajsh te permbushjes se detyrimeve kontraktore te paleve ,keto te fundit duhet te mblidhen dhe te vendosin ne lidhje me permbushjen e detyrimeve te tyre kontraktore .

### Neni 39

#### Njoftim

SIPERMARRESI

Roalb Studio  
Tirane  
Tel .

Autoriteti Kontraktor

Bashkia PESHKOPI  
Tel 0218 221 66

### Neni 40

Cdo ndryshim i kushteve te kesaj kontrate do te behet me shkrim dhe do te nenshkruset nga te dyja palet .

### Neni 41

Sipermarresi eshte i lire ti jape fund kontrates per arsye te falimentimit te firmes se tij .Kontrata merr fund edhe kur behet i paafte per te drejtuar firmen .

### Neni 42

Mosmareveshjet



... e gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin ndermejet paleve ne lidhje me kete kontrate ,do te zgjidhen me mirekuptim ,ne rast te kundert kompetent per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit gjyqesor Diber .

Neni 43


Kjo kontrate quhet e lidhur kur palet kane shprehur ne menyre te ndersjelle vullnetin e tyre ,duke u mare vesh per te gjitha kushtet e saj .

Kontrata u hartua ne tre kopje ,nga te cilat :

- Nje kopje i jepet sipermarresit
- Dy kopje i mbeten autoritetit kontraktor

**SIPERMARRESI**  
Roalb Studio Tirane  
Perfaqesues

Ing.Hamza KAZIA



**Autoriteti Kontraktor**  
Bashkia PESHKOPI  
Kryetari

Ing. Ilir KROSI







REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PESHKOPI

Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Albania

Tel.Fax ++355218 22166, email <bashkiapeshkopi@gmail.com>

VERTETIM

Me ane te te cilit se shoqeria "ROALB STUDIO" sh.p.k. me Drejtues Ligjor z.Hamza KAZIA gjate vitit 2014 ka kryer sherbimin e Hartimit te Projektit Teknik per objektin "Rinovim I Infrastruktures se Bulevardit E. Isufi, rruges S.Zhulali dhe rruges se Muzeut" -Peshkopi,ku vjlera e projektit teknik ka qene 594.000 leke dhe vlera perkatese e llogaritur e preventivit te objektit 110.726.898leke.

Gjate kryerjes se sherbimi theksojme se eshte kryer ne menyre korekte dhe ne perputhje me kontraten e lidhur.

Leshohet ky vertetim sipas kerkeses se te interesuarit.



Nr- 1138 - prof

Date 29/06/2016

**DEKLARATE**

Studio Private Projektimesh Monitorimesh ARBI me Nr. Licence N.6894/4 dhe Studio Projektimesh ALB SUPERVIZION D.S shpk me Nr. Licence N.6316/4 me përfaqësues Irakli Dinaj


**DEKLAROJ SE:**

Nisur nga gjëndja e amortizuar e rrugëve në Bashkinë Peshkopi, duke qënë se jemi frekuentues të rregullt të periudhës Prill – Maj të këtij qyteti, për shkak të ujrave termale, kemi vënë re se ky qytet ka nevojë emergjente për investime në infrastrukturë. Sa më sipër, në konsultë edhe me sektorin e urbanistikës hartuam një projekt për rehabilitimin e disa shesheve dhe rrugicave pas pallatit të kulturës dhe ia dhurojmë pa kundërshpërblim Bashkisë Peshkopi.

**Për Studio Private Projektimesh Monitorimesh ARBI**

Administratori





REPUBLIKA E SHQIPIRESË  
 BASHKIA E QYTETIT PESHKOPI  
 KRYETARI

Adresa : Bulevardi "Eles ISUFI", Peshkopi, ALBANIA. Nr. Tel. 00 355 218 2 2166

KARTELË SHQËRUESE E PRAKTIKËS

Akti protokollar me Nr. 990, mbëritur me datë 15 / 09 / 2014.

Akti dërgohet nga : "ROALB STUDIO" sh.p.k.

me Nr. 10/g Datë 10 / 09 / 2014.

Akti i drejtohet Bashkisë Peshkopi

Përmbledhja e përmbajtjes : Shprehë për dorëzim projekt zbratimi.

Adresohet :

2 Ajet Broks 1.

Është administrues, koordinues dhe trajtimues  
 i punëve në dorëzim sipas praktikës në këtë rast,  
 në bashkëpunim me zyrtarë financiarë, këtu.

Afati i dhënies së përgjigjes : 18.09.2014.


Shënime në lidhje me trajtimin e zgjidhjes :

Dhënia e përgjigjes :

KRYETARI I BASHKISË  
 Ing. Ilir KROSI

*Ilir Krosi*





“ROALB STUDIO” sh.p.k.

Nr. 101/9 Prot.

Dt. 101/09/2014

Drejtuar : Bashkise Peshkopi

Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi, Albania

**LENDA : SHKRESE PER DOREZIM PROJEKT ZBATIMI ME OBJEKT**

**Rinovim i infrastruktures se bulevardit "Elez Isufi",**

**rruges "Safet Zhulali" dhe rruges se "Muzeut".**

Ne baze te kontrates se lidhur ndermjet institucionit tuaj dhe subjektit tone me objekt : Rinovim i infrastruktures se bulevardit "Elez Isufi", rruges "Safet Zhulali" dhe rruges se "Muzeut", bashkelidhur po ju dorezojme projektin e plote teknik te zbatimit sipas kushteve te kontrates.



Nr. i fletes	Titulli i fletes se vizatimit	Formati	Nr. i faqeve	Shenime
	<b>PROJEKT ZBATIMI TEKNIK</b>			
1	HOROGRAFIA E BULEVARDIT	A3	1	
2	PLAN PIKETIMI TOPOGRAFIK	A3	11	
3	PLANSISTEMIMI I BULEVARDIT	A3	10	
4	PROFILI GJATESOR	A3	2	
5	PROFILE TERTHOR	A3	13	
6	SEKSION TIP, DETAJE SHATERVANI, STOLA, KOSHA, PISTONA	A3	8	
	<b>FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE</b>			
E-01	PLANIMETRI DHE PROFIL E KABINES PARAFABRIKAT	A3	1	
E-02	PRERJET TERTHORE TE KABINES PARAFABRIKAT	A3	1	
E-03	PLAN DHE PROFIL TE BAZAMENTIT TE KABINES	A3	1	
E-04	PANJE BALLORE DHE ANESORE TE KABINES PARAFABRIKAT	A3	1	
E-05	PLAN I PAJISJEVE, TOKEZIMIT DHE NDRICIMIT TE KABINES	A3	1	

E-06	SKEMA ELEKTRIKE NJEPOLARE E KABINES	A3	1	
	<b>NDRICIMI I BULEVARDIT</b>			
E-10	PLAN I NDRICIMIT DHE RRJETIT ELEKTIK KM 0+000 - 0+125	A3	1	
E-11	PLAN I NDRICIMIT DHE RRJETIT ELEKTIK KM 0+150 - 0+250	A3	1	
E-12	PLAN I NDRICIMIT DHE RRJETIT ELEKTIK KM 0+250 - 0+350	A3	1	
E-13	PLAN I NDRICIMIT DHE RRJETIT ELEKTIK KM 0+350 - 0+450	A3	1	
E-14	PLAN I NDRICIMIT DHE RRJETIT ELEKTIK KM 0+450 - 0+579	A3	1	
E-15	SKEMA ELEKTRIKE E RRJETIT TE NDRICIMIT	A3	1	
E-16	SKEMA ELEKTRIKE E KUADRIT SHPERNDARES TU NE KABINE	A3	1	
E-17	SHTYLLAT E NDRICIMIT, BAZAMENTI DHE PUSETA	A3	1	
E-18	SPOTET E NDRICIMIT TE DYSHEMESE SE RRUGES	A3	1	
E-19	NDRICUESIT E SHATERVANEVE	A3	1	
	<b>PAMJE NE PRESPEKTIVE</b>			
1	PAMJE NE PRESPEKTIVE	A3	11	
	<b>RELACIONI TEKNIK</b>			
1	RELACIONI TEKNIK	A4	17	
	<b>SPECIFIKIME TEKNIKE</b>			
1	SPECIFIKIME TEKNIKE	A4	94	
	<b>PREVENTIVI I ZBATIMIT</b>			
1	PREVENTIVI I ZBATIMIT	A4	2	
2	PROJEKTI NE PDF, 1 KOPJE CD			

**PROJEKTUESI**

**"ROALB STUDIO" Sh.p.k**

**Ing. Hamza KAZIA**



## FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **Hartim projekt teknik per objektin "Rinovim i infrastruktures se bulevardit Elez Isufi , rruges "Safet Zhulali" dhe rruges se muzeut"**

Kjo Kontratë është lidhur më 08/07/2014, midis Bashkia Peshkopi tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe Roalb Studio të përfaqësuar nga Z.Hamza Kazia tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për kryerjen e shërbimeve, duke i'u referuar Prokurimit


Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 08/07/2014 bie dakord të realizojë Shërbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin e Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Kërkesat e përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit
- Specifikimet Teknike
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur, përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej 594.000 leke (peseqind e nentëdhjete e kater ) me TVSH për kryerjen e shërbimeve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: 59.400 leke në formën e sigurimit të kontratës në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë shërbimet për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për shërbimet e kryera, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.



5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.


Sot, më datë 08/07/2014 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA PESHKOPI

Imz. ILIR KROSI

Emri dhe firma e Përfaqësuesit



Adresa:

Tel:

Kontraktuesi

"ROALB" STUDIO

2. HAMZA KAZIA

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Vula:

Adresa:

Tel:

